

BIBLIOTEKA
KOMBËTARE DHE
UNIVERSITARE
E KOSOVËS



THE NATIONAL
AND UNIVERSITY
LIBRARY
OF KOSOVA



**PROBLEMET E PËRGJITHSHME
TË RUAJTJES
DHE KONSERVIMIT
TË MATERIALIT BIBLIOTEKAR**

Përgatiti: Bedrije Mekolli

Prishtinë
2005

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Përgatiti: Bedrije Mekolli

**PROBLEMET E PËRGJITHSHME TË RUAJTJES DHE
KONSERVIMIT TË MATERIALIT BIBLIOTEKAR**
Qendra e Restaurimit dhe e Konservimit

Botues: Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Kryeredaktor i botimeve:

Dr. Sali Bashota

Redaksia:

Nehat Krasniqi

Dr. Bahtie Gërbeshi

Gjon Berisha

Lektor: Muhamed Çitaku

Dizajni & Realizimi kompjuterik:

Hekuran Rexhepi

Fotografitë: Bashkim Binaku



**PROBLEMET E PËRGJITHSHME TË
RUAJTJES DHE KONSERVIMIT
TË MATERIALIT BIBLIOTEKAR**

Qendra e Restaurimit dhe e Konservimit

Përgatiti: Bedrije Mekolli

Prishtinë
2005

Përmbajtja

1. Përmbajtja	5
2. Hyrje	7
3. Fillet e restaurimit.....	8
4. Metodat ekzistuese të restaurimit.....	9
5. Të riparohet apo të zëvendësohet	12
6. Specifikat e ambientit për ruajtjen e materialeve bibliotekare dhe arkivore.....	13
7. Dëmtimet nga temperatura.....	14
8. Dëmtimet nga lagështia.....	15
9. Dëmtimet nga myku	16
10. Ndotësit atmosferikë.....	17
11. Dëmtimet nga drita.....	18
12. Bartja e aciditetit në letër.....	20
13. Insektet dhe brejtësit e librit.....	21
14. Kujdesi gjatë përdorimit të librave.....	22
15. Pastrimi i librave.....	24
16. Pastat që përdoren në restaurim.....	25
17. Kutitë mbrojtëse.....	25
18. Mbështjellësit e rrafshët.....	26

19. Librat e lidhur me lëkurë.....	28
21. Riparimet	30
22. Dukja e librit të restauruar.....	32
23. Kujdesi për materialet audiovizuale.....	33
24. Kushtet e rekomanduara për ruajtjen e mjeteve audivizuale	35
25. Fjalorth.....	37
26. Burime të rekomanduara nga interneti për restaurim dhe konservim.....	41
27. Literatura.....	45

HYRJJE

Dihet mirëfilli se koleksionet bibliotekare përmbajnë në vete një numër të madh të dorëshkrimeve të vjetra që i takojnë shekujve të hershëm, siç janë: autografe, muzikale, harta, atlase, gazeta dhe revista periodike si dhe materiale të cilat janë të shkruara thuajse në të gjitha gjuhët dhe rrjedhin nga vende të ndryshme të botës. Këto koleksione konsiderohen si trashëgimi e çmueshme kulturore me interes për vendin dhe qytetarët.

Për shkak të rëndësisë që kanë, çdoherë duhet të kihet parasysh fakti se këto materiale mund t'u ekspozohen faktorëve të ndryshëm dëmtues si: ujit, lagështisë, temperaturës, dritës, insekteve etj., ndaj ruajtja dhe restaurimi i kësaj trashëgimie është një ndër prioritetet esenciale të bibliotekave dhe arkivave.

Qëllimi i këtij botimi është që të sigurojë informacione esenciale dhe praktike që janë të nevojshme si dhe t'i ofrojë mundësi stafit bibliotekar dhe arkivor jokonservator, të mbështesin një lloj kujdesi permanent duke aplikuar pro-

gramet ekzistuese të kujdesit të koleksioneve.

Ky botim nuk i plotëson të gjitha kërkesat për ruajtjen dhe konservimin ose përdorimin e koleksioneve, mirëpo ka si qëllim të shërbejë si një preventivë, ose më saktësisht, të pengojë ngadalësimin e prishjes (dëmtimit) së materialeve bibliotekare dhe arkivore, pasi që dihet se dëmtimet nuk mund të ndalen por vetëm të ngadalësohet procesi i tyre. Ky publikim kaq i shkurtër mund të shërbejë vetëm si një hyrje për tema të shumta që bartë përkujdesja dhe përdorimi i materialeve bibliotekare dhe arkivore. Prandaj rekomandohet që lexuesit të lexojnë libra të ndryshme lidhur me këtë temë dhe të hulumtojnë në adresat e dhëna në fund të këtij botimi.

Me rastin e botimit të këtij materiali, falënderoj, Prof .Dr Fetah Halilin i cili më përkrahu me këshillat dhe sugjerimet e tij në këtë fushë.

Fillet e restaurimit

Tradita e restaurimit dhe e konservimit të librit dhe dokumenteve është shumë e vjetër. Synimet e para të kësaj tradite, datojnë qysh nga kohërat e vjetra, ku material themelor për shkrime përdorej papirusi. Deri në vitin 1898, kur në S. Galen u mbajt Konferenca e Parë Ndërkombëtare, nuk ka ekzistuar ndonjë punë e organizuar në nivel shkencor. Kjo Konferencë i dha vetes detyrë që të sensibilizojë çështjen e restaurimit dhe konservimit, në të gjitha anët e botës me qëllim të krijimit të një katalogu të dorëshkrimeve më të vjetra të cilat në atë kohë ishin të rrezikuara. Pas kësaj Konference, u mbajtën edhe shumë kongrese tjera ndërkombëtare, objektiv i të cilave ishte teknika e Restaurimit dhe Konservimit.

Teknika e restaurimit është mjaft e vjetër. Ajo u zhvillua dhe u zofistikua nëpër kohë, duke kaluar nga metodat empirike në ato shkencore, proces ky që mundësoi kryerjen e të gjithave të nevojshme dhe të arsyeshme për restaurim. Të restaurosh do të thotë të bësh të mundur konservimin dhe konsultimin e një veprë në kushte normale, duke përdorur në mënyrë minimale elementet e reja, si dhe duke respektuar në mënyrë gati absolute elementet e vjetëra, që vepra të rikthehet në mynyrë solidedhe të mbetet estetike. Qëllimi i kësaj teknike është ruajtja dhe restaurimi i dokumenteve në letër ose në materiale tjera dhe bërja e tyre e pranueshme për studim.

Profesioni kërkon një përcjellje të vazhdueshme të zhvillimit të shkencës dhe teknologjisë, me qëllim të aplikimit të teknikave të reja në përmbushjen e kërkesave optimale që kërkon profesioni, duke përdorur njehërit kemikaliet që janë të domosdoshme për punë kualitative.

Ndër parimet themelore të këtij profesioni, konsiderohet çështja e përdorimit të materialeve të qëndrueshme dhe prodhimeve që janë plotësisht të parrezikshme për materialin apo artikullin që restaurohet, me qëllim të mënjanimin të dëmtimeve të mundshme.

Metodat ekzistuese të restaurimit

Gjatë etapave të ndryshme kohore, krahas punës praktike të konservimit dhe hulumtimeve laboratorike, njëkohësisht është bërë edhe seleksionimi i metodave të vjetra dhe përdorimi i metodave të reja të punës.

Secila metodë ekzistuese e cila aplikohet në praktikën e

restaurimit, ka anët pozitive dhe negative të saj. Është e natyrshme që një metodë të jetë e dobishme dhe e aplikueshme për libra apo dokumente me përbërje të veçantë, ndërsa mos t'i përshtatet grupit që përbëhet nga ndonjë material tjetër. Se cila metodë duhet të aplikohet në procesin e restaurimit, kjo varet nga lloji i dokumentit, librit ose dorëshkrimit, dhe duhet të dihet se a konservohet për vlerën historike apo për atë estetike. Gjithashtu mënyra e punës varet edhe nga shkalla e dëmtimit dhe kualiteti i letrës që është punuar ai dokument apo çfarëdo lloj materiali qoftë. Kur dokumentet me një vlerë shumë të madhe janë dëmtuar nga agjentë të ndryshëm shkatërrues, duhet ndërhyrë në kohë për t'u kthyer atyre pamjen dhe fortësinë mundësisht sa më afër origjinalit.



Tavolina dhe veglat e punës në laboratorin e BKUK-së

Pavarësisht se cila metodë aplikohet gjatë restaurimit, gjithmonë duhet pasur parasysh që:

- asnjë proces që e dëmton ose dobëson materialin prej të cilit është i përbërë dokumenti nuk guxon të përdoret;
- asnjë shkronjë apo pjesë e ornamentit, asnjë numër, datë ose diçka e ngjashme gjatë restaurimit nuk guxon të dëmtohet, të largohet apo të fshihet nëse është me interes për dokumentin, dorëshkrimin ose librin. Rregulli i përgjithshëm është të mbahen në maksimum pjesët autentike për çdo etapë të lidhjes në mënyrë që në aspektin e jashtëm të dokumentit të jenë të gjitha pjesët e vjetra që kanë mundur të konservohen.
- pavarësisht nga zgjedhjet e shumta të materialeve restauruese, është më mirë që të restaurohet letra me letër, pergama me pergamënë, lëkura me lëkurë, pra të veprohet në këtë mënyrë aq sa është e mundur për materialin;
- çdo herë para fillimit të procesit të punës së konservimit është mirë që secila fletë t'i nënshtrohet procesit të mikrofilmimit. Nëse materiali është i komplikuar dhe nuk lejon një proces të tillë, atëherë duhet të bëhet fotografimi, sidomos i fletëve më të dëmtuara që i nënshtrohen restaurimit të ndërlikuar (komplikuar) përkatësisht konservimit;
- duhet patjetër të bëhet numërimi i të gjitha fletëve, nëse atyre u mungojnë numrat me qëllim që pas përfundimit të punës të kthehen me lehtësi në vendin e tyre;
- çdo proces që realizohet në laboratorin e konservimit dhe restaurimit, duhet të evidentohet në regjistrin (kartelën) e konservimit duke filluar nga përshkrimi i gjendjes së materialit para konservimit, shoqëruar me fotografi të cilat tregojnë gjendjen origjinale para restaurimit, pastaj procesi i

plotë i punës si dhe në fund, duhet të shënohet mënyra e punës si dhe lista e materialeve të përdorura, kështu që konservatorit i mundësohet një lloj lehtësimi i punës në rastet e intervenimeve tjera.

Të riparohet apo të zëvendësohet

Shpeshherë njerëzit hamenden në çështjen e restaurimit të një libri duke konsideruar se restaurimi mund të kushtojë më shumë se vlera e sotme e librit. Kjo mund të rezultojë me pyetjen: A do të jenë shpenzimet e riparimit ose të restaurimit më të larta se sa vlera e tashme e librit?

Është vërtetë vështirë të jepet një përgjigje e saktë në këtë pyetje. Është e vërtetë se librat apo dokumentet, nuk posedojnë vlera të çmueshme si: ari, argjendi apo ndonjë diamant tjetër, mirëpo, ajo ka vlerë të paçmuar sepse mund të jetë unikat, të pasqyrojë një histori të kulturës së atij vendi apo populli ku libri ruhet. Jo vetëm libri, por shumë materiale të ndryshme kanë vlerat e tyre sentimentale që nuk krahasohen me kurrfarë çmimi.

Lidhur me dilemën se a është më mirë të riparohet apo të zëvendësohet një libër, gjithmonë para se të merret vendim për restaurimin e tij, duhet të analizohet rëndësia e atij libri se a ka vlerë si një artefakt, do të thotë, ai i plotëson libri dy kriteret që e cilësojnë librin si të veçantë. Pra, në njërin anë a i përket historisë, traditës, së kaluarës, dhe në anën tjetër, a ka të bëjë me estetikën apo të bukurën. Se a konsiderohet i vlefshëm një libër apo jo, kjo varet nga përmbajtja e të dhënave që ka ai libër. Nëse libri nuk ka vlera si një artefakt historik, atëherë ruajtja (konservimi) i tij mund të konsiderohet

vetëm si një kënaqësi.

Para se të merret vendim për riparimin e librit, konservatorët bëjnë analizën e librit që duhet të riparohet me qëllim që të kenë informata specifike për gjendjen e atij libri. Pas vlerësimit jepet pasqyra e qartë e gjendjes së librit, për riparimet përkatëse që do t'i bëhen. Për një vlerësim të tillë, konservatorët udhëhiqen nga disa faktorë që do të jepen në vijim:

Struktura - analizohet përbërja e lidhjes së librit nëse është qepur nëpër fashikuj, ka mbiqepje, qepje të jashtme, apo është e lidhur (ngjitur) me ngjitës;

Lloji i letrës - kontrollohet se çfarë lloji letrë është përdorur në tekst;

Gjendja e letrës - shikohet se a është letra e fortë (e qëndrueshme) apo e brishtë (e thyeshme);

Vlera – shikohet vlera thelbësore e librit.

Specifikat e ambientit për ruajtjen e materialeve bibliotekare dhe arkivore



Instrumenti për matjen e temperaturës dhe lagështisë relative në BKUK

Dihet se librat, letrat dhe artikujt tjerë në biblioteka dhe arkiva përbëhen nga komponentë të ndryshme, jetëgjatësia e të cilave varet nga karakteristikat e kësaj përbërje dhe kushtet e ambientit ku janë të vendosura. Kontrollat e rrepta të ambientit janë të domosdoshme me qëllim të ngadalësimit të shkallës së dëmtimit.

Ndër preventivat e arritshme për

ngadalësimin e dëmtimit të letrës janë lëvizjet minimale të temperaturës dhe lagështisë relative, për të cilat do të bëhet fjalë në vijim.

Faktorë që ndikojnë në prishjen e letrës janë temperatura, drita, lagështia relative, ndotësit atmosferikë, gjithashtu rritja e mikroorganizmave, siç janë myku, bakteret, insektet dhe brejtësit të cilët ushqehen me letër.

Dëmtimet nga temperatura

Dëmtimet më të shpeshta të materialeve bibliotekare dhe arkivore janë kryesisht të natyrës kimike, sidomos ndryshimet e shpejta të temperaturës të cilat nxisin reaksionet të ndryshme kimike që shkatërrojnë këto materiale. Temperatura e lartë e kombinuar me lagështi të madhe, mund të nxisë apo të shpejtojë reaksionet acidike të cilat konsiderohen faktor i rrezikshëm që ndikojnë në prishjen e letrës. Në këtë mënyrë jeta e letrës mund të zgjatet nëse ajo ruhet në temperaturë të ultë. Mbajtja e temperaturës konstante në nivel 68 shkallë Fahrenheit, konsiderohet si temperaturë ideale edhe pse dihet se nuk mund të ekzistojë një temperaturë e tillë ideale për të gjitha materialet. Pra, temperatura duhet të jetë e lartë që të jetë e përshtatshme për punëtorët, ndërsa e ulët që të mos i dëmtojë materialet.

Amplituda e gjerë e fluktacioneve në temperaturë është jashtëzakonisht shkatërruese, prandaj letrat dhe librat kurrë nuk duhet të ruhen apo vendosen në ambiente me nivel të lartë (në kulme) ku zakonisht lëvizjet e temperaturës janë të mëdha, ku temperatura mund të jetë 150 Fahrenheit, që zakonisht ndodhë gjatë ditëve të verës.

Dëmtimet nga lagështia

Lagështi Relative (L.R) konsiderohet madhësia ndërmjet sasisë së avullit të ujit në ajër dhe sasisë që ngopë ajrin (100 L.R) në temperaturën e dhënë dhe shtypje barometrike. Lagështia relative mbi 68%, shkakton fryrjen dhe shtrembërimin e fibrave të letrës si dhe përshpejton procesin e aciditetit (dëmtimin acidik).

Edhe nëse nuk ka ujë në hapësirë, lagështia e madhe e ajrit, në afërsi të pjesëve të metalta dhe kapëseve të letrës, shkakton njolla ndryshku.



Libër i dëmtuar nga lagështia

Përveç lagështisë së tepërt, edhe mungesa e lagështisë, (lagështia e ulët nën 40%) ndikon negativisht në materialet duke shkaktuar tharjen e letrës nga jashtë me ç'rast arrin deri te dobësimi dhe thyeshmëria e fletëve.

Këshillohet që letra moderne e librave që botohen tash, të

ruhet në 40%-50% lagështi relative, librat me lidhje-lëkurë të ruhen prej 45% lagështi relative, ndërsa pergamena prej 50%-60% lagështi relative. Përgjithësisht, një kompromis i mirë është ruajtja e materialit në 50% lagështi relative me një kufi të pranueshëm prej 46%-60% lagështi relative.


Niveli i lagështisë në hapësira të vogla të depove mund të ruhet me një aparat klimatizimi - tharës ajri (dehumidifer) që e zvogëlon lagështinë, apo lagështues (humidifer) që e rrit lagështinë.

Vendet e ruajtjes së materialeve nëpër depot në podrumë, përgjithësisht nuk janë të dëshirueshme për shkak të vërshimeve (përmbytjeve) të mundshme dhe zakonisht për shkak të nivelit të lartë të lagështisë.

Dëmtimet nga myku

Një ndër faktorët që mund të dëmtojnë librin, konsiderohet edhe myku. Ruajtja e materialeve në kufijtë e rekomanduar, si për temperaturë ashtu edhe për lagështi relative parandalon rritjen e mykut. Sado që sporet e mykut janë gjithmonë prezent në ajër dhe në pluhur, ato ngjiten në dokumente. Nëse kushtet e rekomanduara nuk përmbushen, atëherë rreziku i rritjes së mykut është i pashmangshëm.

Lagështia relative 70% e kombinuar me temperaturën e lartë nxit rritjen e mykut ose mykosjen, megjithëse disa myshqë rriten në temperaturë të ultë si p.sh. 40 shkallë Fahrenheit nëse lagështia është e lartë. Kushtet e ambientit të paajrosur gjithashtu nxisin rrezikun nga myku. Kur fillon të zhvillohet myku, është vështirë më pas të kontrollohet, andaj edhe mund të ndodhin dëmtime serioze. Me këtë rast, preventiva



Libër i dëmtuar nga myku

është shumë më e lehtë sesa riparimi.

Ambienti duhet të monitorohet sipas kriterëve të caktuar me qëllim që të largojë kushtet që nxisin krijimin e mykut. Në fazën fillestare, rritja e mykut nuk është shumë e bezdisshme. Kur ai ka prekur një pjesë të madhe të koleksioneve, zona izolohet menjëherë dhe kërkohet ndihmë nga specialisti mykolog. Në qoftë se janë pak materiale të infektuara ato veçohen nga pjesa tjetër e koleksioneve si dhe pastrohen dhe thahen. Njollat që janë të dukshme mund të pastrohen lehtë me brushë në mjedis të hapur dhe artikulli mund të ruhet në kushtet e rekomanduara pa u brengosur për fazat e mëtutjeshme.

Ndotësit atmosferikë

Fondet bibliotekare, përfshirë libra, letra, dokumente etj., mund të dëmtohen edhe nga ndotësit atmosferikë gjatë qarkullimit të

ajrit të ndotur nëpër atë ambient. Karakteristikë e materialeve që atakohen me dëmtime nga ndotës të tillë, është çngjyrosja (zbardhja e ngjyrës – fshirja e tekstit të shkruar) e materialit që bie në kontakt me këta ndotës. Gazrat e caktuara kimike siç janë; dioksidi i sulfurit, hidroksidi i sulfurit, oksidet e azotit dhe ozoni absorbohen nga ajri në letër dhe e zmadhojnë në një masë dëmtimin e letrës, dobësojnë apo shkatërrojnë strukturën e fijeve të letrës duke e shkatërruar atë.

Për shkak të dëmtimeve të mëdha nga pluhuri dhe ndotësit tjerë të absorbuar, të cilët mund të gërryejnë librat dhe letrën, ajri në depo (ku gjenden librat) duhet të filtrohet duke i pastruar (ndërruar) shpesh filtrat që janë të vendosura në sistem. Nëse filtrimi është i pamundshëm, materialet duhet të ruhen në kontejnerë të mbyllur, apo në çanta plastike ku duhet të ketë hapësirë që të mos jenë të shtypura. Nëse përdoren kuti mbrojtëse nga pluhuri dhe papastërtia, ato duhet të jenë të ndërtuara në atë mënyrë që të mund të sigurojnë qarkullimin e ajrit nëpër to përmes filtrave.

Në rastet kur ajri është i palëvizshëm, ekziston mundësia që të vijë deri te zhvillimi dhe rritja e mykut, andaj materialet e ruajtura në kontejnerë të mbyllur apo në kutia, duhet t'u nënshtrohen kontrolleve të shpeshta. Edhe hapësira duhet të fshihet dhe pastrohet rregullisht me fshesë elektrike (thithëse vakum) me qëllim të eliminimit të pluhurit dhe njollave të vendosura në ndonjë material.

Dëmtimet nga drita

Dëmtues të materialeve bibliotekare dhe arkivore konsiderohen edhe gjatësitë valore të dritës. Ekspozimi i rrezeve ultraviolete të dritës e cila përfshin gjatësinë valore më të vogël se

400 nanometra dhe që mund të shihet vetëm me sy, pa mjete optike, shkakton dëme të paparashikueshme. Drita e diellit, e cila ka një përqindje më të lartë të rrezatimit UV (ultraviolet) dhe përcillet me një dritë të skuqur e fluoreshente, shkakton dëmtimin e shpejtë të letrës, lëkurës dhe pëlhurës. Reaksionet kimike që shkaktohen nga ekspozimi në dritë, vazhdojnë edhe pasi burimi i dritës është mënjanuar, prandaj materialet me vlerë të veçantë ruhen në errësirë, pasi dëmtimi nga drita është i pa rikthyeshëm.

Efektet e dukshme të dritës ndikojnë në: zbardhimin, zbehjen, fshirjen apo venitjen e letrës si dhe marrjen e ngjyrës së kaftë që ndodh më së shpeshti tek gazetatat.

Letra e ruajtur në errësirë të plotë ruhet më gjatë sesa ajo e cila i nënshtrohet dritës. Me gjithë dëmet që shkakton drita, ndriçimi në biblioteka dhe arkiva është i pashmangshëm andaj këshillohet të përdoret ai që është më pak i dëmshëm.



Kupola plexiglas - mbrojtës efikas nga rrezet ultraviolete

Letra kurrë nuk duhet të qëndrojë drejtpërdrejtë në dritën e diellit ose në tubat e pambrojtura fluoeshente. Materialet specifike të filtrimit ultraviolet, siç janë: plexiglas UF-3 dhe akrilik OP-2, mund të përdoren për qëllime mbrojtëse.

Shpeshherë në ambientet ekspozitare janë të vendosura dritat fluoeshente të cilat dëmtojnë materialin e ekspozuar. Nëse një dokument kërkohet të vihet në kornizë dhe të ekspozohet, atëherë atij dokumenti duhet t'i vendoset astar, material me karton joacidik me qëllim të mbrojtjes nga kontakti direkt i dritës.

Megjithëse këto mbrojtëse janë të shtrenjta, përdorimi i tyre është i domosdoshëm pasi që dokumentet e ekspozuara janë afër burimit të dritës dhe në këtë mënyrë ato pranojnë sasi të lartë të radiacionit ultraviolet.

Bartja e aciditetit në letër

Shpeshherë mospërdorimi i mbështjellësve joacidikë, astarëve, kartonit dhe materialeve tjera mbrojtëse, për ruajtje të materialeve, rezulton në bartjen e acidit, gjegjësisht në lëvizjen e tij nga materialet acidike tek ato më pak acidike. Dokumentet e vlefshme duhet të deacidifikohen me zbutës nga konservatorët kompetentë për letër, dhe të ruhen në dosje të palosura joacidike, në kontejnerë (vende të mbyllura).

Shembujt e njohur të bartjes së acidit është të kaftit, gjegjësisht humbja e ngjyrës. Kjo vihet në dukje zakonisht kur copat e prera të gazetave janë ruajtur në libra të vjetër.

Insektet dhe brejtësit e librit

Insektet përbëjnë një klasë të veçantë dëmtuesish dhe shtrajnë probleme të rëndësishme për mbrojtjen e dokumenteve bibliotekare. Dëmet që shkaktojnë insektet dhe brejtësit janë shumë të mëdha dhe serioze. Zakonisht objekt shkatërrimi nuk janë vetëm shpina dhe kapakët e librave në të cilat ato gjejnë ushqimin kryesor, por janë edhe vetë dokumentet.

Pjesa më e madhe e insekteve dhe brejtësve, në ambientet e ruajtjes së materialeve arkivore dhe bibliotekare, hyjnë në rrugë të ndryshme:

- së bashku me dokumentet
- nëpërmjet dyshemesë, dritareve etj.

Insektet dhe brejtësit e librit zakonisht nxiten nga celuloza e letrës, proteinat dhe karbohidratet, masa e xhelatinës, ngjitësit, lëkura dhe substancat tjera organike.

Mënyra më e sigurt që të largohen insektet dhe brejtësit është që të ndërmerren këto masa:

- dritaret të pajisen me rrjeta
- të mbahet pastërti në tërë hapësirën ku ruhen dokumentet
- të merren rregullisht pluhurat në ambientet e ruajtjes së librave me thithëse pluhuri
- kontrolli i vazhdueshëm i librave dhe ambientit
- të ndalohet rreptësisht sjellja e produkteve ushqimore në vendet e ruajtjes së këtyre materialeve
- të mos ketë rritje të lagështisë dhe luhatje të mëdha të temperaturës së ajrit

Rëndësi të madhe ka edhe marrja e masave kurative, shfarosëse, për të cilat përdoren insekticide të ndryshme.

Rast tjetër parandalues për ruajtjen e materialeve nga insektet



Peshku i argjendtë-Lepisma saccharina (Linn.)



Insekti dhe libri i dëmtuar nga ai

është edhe vendosja e një ene të vogël e të hapur me përmbajtje: paradiklorbenzen, ose naftalinë në raftet e librave. Paradiklorbenzeni është një helm, ndaj duhet t'i kushtohet kujdes përdorimit të tij.

Nëse insektet janë gjetur në dokumentet e ruajtura, atëherë ato dokumente duhet të vendosen së pari në një kontejnerë të mbyllur me paradiklorbenzen ku duhet të qëndrojnë tri javë, si kohë e mjaftueshme për eliminimin e insekteve dhe vezëve të tyre.

Gjatë dezinfektimit, spërkatjeve të dyshemesë, mureve,

dritareve, duhet pasur kujdes që solucioni të mos bjerë mbi materiale, për shkak të mundësisë së njollosjes së tyre apo mundësisë së ngjyroshjes.

Kujdesi gjatë përdorimit të librave

Tërheqja e librit nga rafti: Jo rrallë, ndodh që njerëzit gjatë përdorimit të librit të jenë të pakujdesshëm, gjatë përdorimit të librave apo materialeve tjera. Kjo pakujdesi nis që nga tërheqja e materialit nga rafti, vazhdon gjatë leximit, e deri te kthimi i tij në vend. Kjo pakujdesi rezulton me dëmtime

serioze të tij. Tërheqja e librit nga rafti, duke i ngulitur thonjtë fuqishëm, duke i ndrydhur librat tjerë përreth, duke e tërhequr nga shiriti që gjendet i ngjitur në libër, duke përdorë ndonjë mjet për tërheqje (vizore, laps apo shufër metalike) është mënyrë e shpeshtë e dëmtimit të tij.

Për t'iu shmangur këtyre dëmtimeve, është e këshillueshme që gjatë tërheqjes së librit nga rafti, të tërhiqet tehu i sipërm i shpinës së librit. Së pari duhet të shtyhen prapa disa libra nga të dy anët dhe më pas duhet të tërhiqet libri pa e përcaktuar se në cilën pjesë të kapet.

Edhe librat që janë të radhitura në mënyrë të pjerrët apo të prirura nga njëra anë mund të dëmtohen lehtë. Këshillohet që ato të qëndrojnë drejtë, ndërsa në mungesë të ndonjë libri në fund, është mirë të vendosen disa vëllime të rrafshta (të shtrira) në vëllimet që qëndrojnë vertikalisht (në këmbë) si një lloj bazamenti për vendosje cilësore.



Mënyra e tërheqjes së librit nga rafti

Në rastet kur libri është i vjetër, nuk duhet përdorur forcën për të hapur atë nëse ai nuk do të hapet vetë, pa forcë. Në rastet e tilla rekomandohet që libri të hapet në formën e shkronjës V dhe të përforcohet duke përdorur mbështjellës petëzor pëlhere.

Duhet e pasur kujdes që gjithmonë vëllimet e rënda të hapen në mes, dhe vetëm pasi kjo është e shtrirë (drejtuar) në këtë mënyrë, lejohet të kalohet (kapërcehet) fleta.

Pastrimi i librave

Gjatë procesit të pastrimit të librave parapëlqehet përdorimi i pëlhurave të llojit *Wipe*, ose përdorimi i një pëlhere të pastër që do të reduktojë përhapjen e pluhurit.

Padyshim me goma fshirëse të posaçme mund të pastrohen mbështjellësit (kapakët) e librit dhe ndonjë njollë në sipërfaqe të fletëve. Ekziston mundësia të përdoret edhe ndonjë brushë me qime të buta, mirëpo kjo duhet të praktikohet para përdorimit të gomës. Për t'i ikur gërryerjeve të mundshme gjatë pastrimit, duhet të përdoren goma speciale siç janë ato të tipit *Faber's, PinkPearl, Magic Rub* dhe goma fshirëse speciale që përdoren në artet figurative. Mund të përdoren edhe goma të grimcuara mbi sipërfaqen e njollosur, duke i fërkuar me kujdes, me lëvizje rrethore, njollat me majet e gishtave (mollëzat).

Për të zvogëluar mundësinë e dëmtimit të mëtutjeshëm, preferohet të punohet duke filluar nga mesi i fletës dhe për të përfunduar në periferi të saj. Kur të mbarojë procesi, duhet të largohen të gjitha grimcat e mbetura nga goma. Në qoftë se përdoren goma të forta mund të paraqiten njolla

dëmtuese, kështu që zgjedhja e cilësisë e gomës është mjaft me rëndësi në këto raste.


Pastat që përdoren në restaurim

Shumica e pastave (ngjitësve) përdoruese që qarkullojnë sot në treg, janë me përbërje acidike. Përdorimi i këtyre pastave në restaurim, ndikon në thyeshmërinë e dokumentit që restaurohet, duke e humbur ngjyrën dhe dëmtuar atë. Pasi që pastat janë baza ujore, ato mund të deformojnë dhe të nxijnë dokumentin.

Ngjitja e rripave (pjesëve) të letrës së hollë me pastë orizi siguron riparime të cilat janë thuajse të padallueshme për shumicën e materialeve në të cilat përdoret si dhe janë reversibile (të kthyeshme). Çdoherë pas secilit riparim, duhet të pastrohet hapësira ku është punuar si dhe veglat të cilat janë përdorur në këtë proces.

Kutitë mbrojtëse

Përdorimi i kutive të poliesterit është mënyra më e mirë për mbrojtjen e dorëshkrimeve materialisht të dobëta, (kryesisht materiale të thyeshme dhe të dëmtuara,) për mbrojtjen e hartave dhe dokumenteve të veçanta që ruhen nëpër biblioteka. Varësisht prej rrethanave, në rast se libri është shumë i dëmtuar dhe riparimi i tij mund të jetë i rrezikshëm, për t'iu shmangur këtij riparimi, mund të përdoren kutitë e bëra enkas për ruajtjen e tij. Kjo është zgjedhja më e mirë, në rastet kur librat kanë vlerë si një artefakt, dhe riparimet do t'ia humbin vlerën e tyre origjinale.



Kutia për mbrojtjen e materialit bibliotekar dhe arkivor

Kutitë janë mundësi e mirë edhe në rastet kur gjendja e letrës është shumë e thyeshme dhe çdo riparim eventual do të jetë pengesë për të. Kutitë e tilla përveç që i mbajnë librat e dëmtuara, ato njëkohësisht i mbrojnë ato libra nga pluhuri dhe drita.

Mbrojtje më të efektshme kutitë ofrojnë nëse ato i përshtaten madhësisë së librit. Kutitë e tilla duhet të punohen vetëm nga materialet stabile të cilat nuk do të ndikojnë në prishjen graduale të librit në të ardhmen.

Mbështjellësit e rrafshët

Letrat të cilat për një periudhë të gjatë kanë qenë të paluara, apo të mbështjellura rrotull, zakonisht thahen dhe bëhen të thyeshme. Rrafshimi i tyre gjatë përdorimit mund të shkak-

tojë thyerje të fibrave të celulozës me dëmtim të përhershëm të letrës. Me këtë rast këshillohet të bëhet rikthimi i lagështisë së letrës. Ky rikthim mundëson lirim dhe zbutjen e fibrave duke e bërë letrën sa më elastike me qëllim që të rrafshohet lirshëm. Mënyra më e mirë e rikthimit të lagështisë është metoda e vendosjes së letrës në sipërfaqe me lagështi të lartë rreth 100% të lagështisë relative për një ose dy ditë. Dokumentet mund të vendosen në një kontejnerë me ujë ose me sfungjer të lagësht në atë mënyrë që uji nuk është në kontakt me materialin.

Në vendet e thata, në mungesë të lagështisë së mjaftueshme preferohet krijimi artificial i lagështisë së atij vendi. Me këtë rast, është mjaft e dobishme dhe e lehtë mundësia që të vendoset një enë plastike me ujë në raftë ku janë të vendosura materialet. Letra nuk duhet të jetë në kontakt me asnjë lloj uji të kondensuar (përmbledhur) që formohet në murin e enës mbajtëse (kontejnerës)

Në raste tjera, materialet e mbështjella rrotull mund të pastrohen me shpuzë të lagur. Rreziku që mund të pasojë nga kjo metodë është njollosja e materialit nga ngjyra e shkrimit e cila nuk është rezistente në ujë. Pasi që të rrafshohet letra, duhet të thahet nën presion. Fletët e veçanta ose grupe të vogla fletësh duhet të ndahen me letër thithëse të bardhë ose me karton dhe të vendosen mbi to disa materialet të rënda, siç janë shtypësit e drurit apo ndonjë material tjetër, dhe të qëndrojnë kështu një ose dy ditë, derisa ato të thahen.

Librat e lidhur me lëkurë

Dëmtimet e lëkurës

Faktorët që ndikojnë në prishjen e lëkurës, janë të varur kryesisht nga kualiteti dhe mosha e lëkurës dhe procesi i përpunimit (rethjes) të saj, proces nga i cili është arritur edhe qëndrueshmëria e lëkurës. Lëkura e prodhuar para shek. XVII, ka qenë e kualitetit të mirë dhe ka pasur qëndrueshmëri të gjatë, ndërsa prodhimet pas shek. XVII, nxisin prishje të shpejta dhe të vrazhda.

Tek lëkurat e vjetra, për procesin e rethjes, janë përdorur kripëra zbutëse të cilat i kanë zvogëluar dëmtimet evidente. Këto kripëra kanë humbur ose mungojnë te lëkurat moderne. Minerale acidike të forta nga ndotësit e ajrit dhe acidi sulfurik kontribuojnë në dëmtimin dhe shkatërrimin e lëkurës.

Lagështia Relative nën 40% shkakton tharjen e lëkurës dhe prishjen; nga ana tjetër, lagështia e lartë e shpejton prishjen kimike të lëkurës. Drita, madje edhe drita indirekte e diellit, shkakton zbehjen, ose errësimin e ngjyrës në lëkurë. Lidhjet speciale me lëkurë duhet të mbrohen në kutia të bëra nga materialet inerte dhe të padepërtueshme.

Fleksibiliteti dhe elasticiteti i lëkurës varet nga veprimi i rrëshqitjes së fibrave të cilat ndikojnë që lëkura të bëhet e thatë nëse nuk lubrifikohet (lyhet). Në këtë mënyrë një hap i rëndësishëm në ruajtjen, konservimin e lëkurës është zëvendësimi i vajrave natyrale që mund të jenë oksiduar. Në disa raste, para lubrifikimit – lyerjes, lëkura mund të ketë nevojë të laget përsëri me qëllim që ta kthejë lagështinë e

duhur.

Acidi sulfurik i përdorur në përpunimin e lëkurës moderne është tepër vështirë të largohet. Ndërsa humbja e kripës mund të zëvendësohet me laktat kalium i cili shërben si kripë zbutës dhe e neutralizon ndonjë mineral acidik të fortë.

Pastrimi i librave të lidhur me lëkurë

Në lëkurën poroze ose të ngjyrosur lehtë, si dhe në të gjitha lëkurat tjera, tretësit (solucionet) e ujit krijojnë njolla të errëta si dhe ngurtësim të materialit.

Nëse lidhja është e papastër, atëherë ndyrësira e sipërfaqes largohet me pëlhurë liri të butë, të lagur pak me ujë, laktat kaliumi ose me sapun. Së pari, duhet provuar të pastrohet një njollë që nuk vërehet shumë, për t'u siguruar që errësimi nuk do të ndodh; dhe nëse është përdorur sapuni të gjitha mbetjet duhet të largohen, duke përdorur leckë të butë e të pastër dhe duke bërë lëvizje të lehta.

Brushat nuk janë edhe aq të volitshme, për pastrimin e lëkurës, sepse nuk mund të sigurojnë efikasitet gjatë përdorimit të tyre si dhe nuk mund të kontrollohet në mënyrë rigoroze sipërfaqja ku është aplikuar veshja. Emulsioni i Polivinil Acetatit, letrat dhe lustrat nuk duhet të përdoren kurrë në lidhjet me lëkurën ngaqë mund të shkaktojnë ngjitjen e lidhjeve lëkurore.

Nëse kemi të bëjmë me libra shumë të vlefshme, së pari duhet kërkuar instruksione nga konservatorët specialistë.

Riparimet

Zakonisht pjesët e librit që duhet të riparohen më së shumti janë menteshat (nyjet) ku kapaku i librit ose mbështjellësi i librit takohet apo ndeshet me shpinën. Këndet (tehet) e mbështjellësit gjithashtu kanë nevojë të riparohen shpesh pasi që këto pjesë të librit përdoren më së shumti.

Këto riparohen duke përdorur materiale të tipit të njëjtë dhe të ngjyrës së ngjashme

Gjerësia e copës riparuese varet nga masa e riparimit. Kjo pjesë determinohet ose kushtëzohet sipas nevojës së pjesës së dëmtuar (pra të jetë adekuate), për të sjellur librin në gjendjen sa më afër origjinalit. Që të sigurohet ngjashmëria maksimale, copa është më mirë të grisit sesa të prehet me gërshërë.

Duke përdorur brushë specifike artistësh, të lagur me ujë, duhet të tërhiqet një vijë ku do të bëhet grisja. Me këtë rast uji e dobëson letrën dhe mundëson të bëhet grisja më lehtë, duke i mbuluar me fije skajet. Gjithashtu për këtë çështje, janë të nevojshme: një shufër metalike antikorozive, një thikë specifike artistësh ose shpatull për shpërndarjen e pastës, si dhe një sipërfaqe punuese të rrafshët e cila duhet të jetë e mbuluar me një masë plastike ose xham me qëllim të evitimit të çfarëdo substance yndyrore gjatë palosjes së fijeve të pjesës riparuese (materialit që përdoret për riparim).

Duhet të shtypet fundi letrës së grisur, pastaj të bashkohet lehtësisht me gishta, duke u siguruar që pjesët të shkojnë bashkë në rregull derisa të vihet sasi e vogël e pastës. Më pas me anë të spatullës, duhet të vihet pak ngjitës (pastë) në letër, ku letra bëhet transparente derisa pasta thithet. Duhet të


largohet çdo tepriçë e pastës. Duhet të tërhiqet njëri skaj i letrës me maje të shpatullës dhe me kujdes të vendoset mbi grisje (mbi vendin e shqyer).

Letra me të cilën riparohet dokumenti duhet te përdoret me kujdes gjatë ngjitjes së saj me dokumentin apo me materialin që riparohet.

Derisa riparimi është ende i njomë, por jo gjatë i ngjitur, duhet të shtypet dokumenti që të pengohet çfarëdo valëzimi. Për të eliminuar mundësinë e çfarëdo ngjitjeje, përdoret letër dylli mbi riparim dhe shtypet fleta në mes të kartonit të hollë ose letër thithëse të bardhë duke përdorë peshë të lehtë. Grisjet e gjata duhet të bëhen me disa copa (shirita) të vogla të cilat përputhen me njëra tjetrën. Praktikohet që kjo metodë së pari të provohet në letër më pak të rëndësishme, dhe nëse paraqitet ndonjë dëmtim, atëherë pasta lehtë mund të largohet me ujë nga letra.

Për shkak të llojeve të shumta të lëkurave dhe materialeve tjera si dhe gjendjes të këtyre materialeve për riparim, secili libër duhet të trajtohet si i veçantë Për këtë arsye në të gjitha pikëpamjet, materialet riparuese duhet të jenë në harmoni me kualitetin dhe llojin e secilit libër. Riparimet në dokumentet e rëndësishme bëhen duke iu shmangur dëmtimit të mëtutjeshëm të materialit.

Shiritat e ndjeshëm senzitivë, siç janë shiriti celofan (*Scotch*) dhe shiriti "*Magic Mending*", nuk janë të përshtatshme për riparime, ngaqë të dy llojet shkaktojnë njolla dhe vështirë largohen pa dëmtuar dokumentin. Për këtë arsye, shiritat ngjitës të letrës duhet të largohen nga përdorimi.



Shiritat ngjitës sensitivë

Emulsioni i Polivinil acetatit siç është “*Elmer’s Glue-All*” është e pamundur të largohet pa dëmtuar letrën, ngaqë ky emulsion është shpesh acidik si dhe çngjyros dhe shkatëron letrën.

Dukja e librit të restauruar

Libri i restauruar duhet të jetë sa më origjinal, gjegjësisht duhet ta ruajë pamjen e mëparshme, pavarësisht se i është nënshtruar procesit të restaurimit. Ai duhet të ketë material origjinal sa më shumë që është e mundur dhe ende ta ruajë përdorshmërinë e tij.

Është me rëndësi të theksohet se të gjitha proceset që aplikohen ne restaurim duhet të jenë në harmoni me stilin dhe kohën në të cilën libri është punuar. Edhe materialet që përdoren duhet të jenë arkivisht stabile dhe kurdoherë reversibile.

Detyrë esenciale e restauratorit të librit është të ruajë tërësinë

e librit derisa ai bëhet i përdorshëm në kohën aktuale dhe konservohet për të ardhmen. Ndonëse duhet t’i kushtohet rëndësi dukjes së mëparshme, është e dëshirueshme që riparimet të jenë sa më të padukshme (të mos bien në sy) që është e mundur.




Pamja e librit para dhe pas restaurimit

Me qëllim të ruajtjes së origjinalitetit të librit, procesi i rilidhjes, restaurimit dhe veshjes së imituar, duhet të realizohet në të njëjtën mënyrë, duke aplikuar metodat e përdorura nga libërlihdhësit origjinalë.

Kujdesi për materialet audiovizuale

Një sfidë e madhe për ruajtjen e materialeve bibliotekare dhe arkivore paraqitet tek mjetet audiovizuale apo digji-



Pllaka të dëmtuara

tale, siç janë: shiritat magnetikë, disqet optike dhe dokumentet digjitale të cilat tash përhapen në masë të madhe. Kjo ruajtje e informatave paraqet një problem të ri, ngaqë ato materiale për një kohë të shkurtë jashtëzakonisht dobësohen. Mjetet audiovizuale zakonisht janë më jetëshkurtër sesa mediat tradicionale si dhe vështirë ripërtërihen.

Nëse një dokument nga letra gërvishtet ose tkurret, nuk është problem të ripërtërihet, mirëpo nëse një kompakt disk (CD) gërvishtet ose tkurret, atëherë të gjitha informatat e ruajtura në të mund të humbasin.

Shumica e mediave moderne që i përkasin teknologjisë së lartë, ("High Tech") kanë jetë më të shkurtër se sa mediat moderne tradicionale bibliotekare. Edhe nëse ato qëndrojnë të paprekura fizikisht, ruajtja e informatave nuk është e sigurt.

Shiritave magnetikë do t'u humbasë efekti i magnetizimit me kohë, pavarësisht nga ruajtja e ambientit. Edhe disqet optike mund të humbin vlefshmërinë e tyre për shkak të ndonjë gërvishtjeje ose plasaritjeje mikroskopike që mund të lëshojë ajrin brenda dhe në këtë mënyrë të vijë deri te krijimi i shtresave të ndryshme të njollave.

Kushtet e rekomanduara për ruajtjen e mjeteve audiovizuale

Të dhënat e regjistruara në mjetet audiovizuale, veçanërisht janë të ndjeshme ndaj pluhurit, papastërtisë, ndotjes dhe gërvishtjes, ndaj ato duhet rregullisht të pastrohen dhe mirëmbahen në hapësirat ku ato janë të vendosura.

Bazuar në standardet e praktikave, të zhvilluara në ruajtjen e mjeteve audiovizuale, rekomandohet që këto materiale të ruhen në hapësirat me temperaturë të ftohtë dhe të thatë: $15\pm 3C$ ($59\pm 5F$) ndërsa në lagështi relative 30-40%. Këto janë kushtet më të volitshme për ruajtjen e këtyre materialeve. Nxehësia dhe ngricat ekstreme ndikojnë dukshëm në dëmtimin e mediave magnetike. Në këto raste, lagështia relative mbi 40% shpejton prishjen e lidhjeve të shiritit.

Për një preventivë sa më të mirë duhet të shmangët vendosja e shiritave magnetikë në ato vende ku janë ndryshimet e shpejta të temperaturës. Mediat optike, laserët optikë, kompakt disqet (CD-të), audiokasetat dhe shiritat magnetikë të ngjashëm duhet të ruhen në kutia të mbyllura, në errësirë, në temperaturë të freskët dhe të thatë, larg dritës, larg fushave magnetike dhe larg fluktacioneve klimatike.

Praktikohet që çdo vit të inspektohen materialet e ruajtura në aparatet përkatëse audiovizuale. Paraprakisht, para se ato të kontrollohen se a janë të përdorshme, duhet të kihet kujdes që aparatet me të cilat ato inspektohen të punojnë në rregull, sepse nëse ato aparate, (kompjuterë, CD-player, video player, magnetoskopë etj) janë të dëmtuara apo përmbyajnë viruse të ndryshëm, mund edhe të humbin të dhënat e ruajtura. Këto të dhëna duhet të mirëmbahen në vend të sig-

urt si dhe të bëhen kopje për përdorim rutinor. Gjatë procesit të kopjimit të tyre, çështje me rëndësi është edhe mjeshtëria e përdorimit të atij materiali medial.

Është e preferueshme që në mënyrë periodike të barten dhe të modifikohen të gjitha të dhënat në harduer apo softuer që aplikohet. Kjo është me interes të posaçëm, ngaqë krahas zhvillimeve të reja harduerike dhe softuerike, modifikohen edhe materialet audiovizuale, me qëllim që të bëhen të aplikueshme në çfarëdo sistemi ekzistues në të ardhmen.

Fjalorth

Arkivisht stabil	term që sugjeron se një material, produkt apo proces është i qëndrueshëm dhe kimikisht stabil, që ka jetë të gjatë dhe prandaj mund të përdoret për qëllime të ruajtjes.
Artefakt	punë dore, prodhim artificial
Brishtë	veti apo gjendje që shkakton dëmtimin e materialit kur të thyhet apo palohet. Letra thuhet të jetë e brishtë kur një skaj nuk i qëndron palimeve të plota të dyfishta
Celulozë	lëndë e fortë e patretshme, që nxirret nga përpunimi i drurit dhe përdoret për prodhimin e letrës. Përbërësi kryesor i mureve të qelizës bimore
Dehumidifer	aparaturë për tharjen e ajrit
Fahrenheit	njësi matëse për temperaturë
Fibra	fije, pejë
Fluktacion	lëkundje, luhatje

Humidifer	aparati për rritjen e lagështisë së ajrit
Joacidik	pa acid, material që nuk përmban acid
Konservim	ruajtje në gjendje të mirë të ndonjë materiali (libër, dokument, pikturë etj.) që të mos e dëmtojë koha (të ruhet i paprishur)
Menteshë	shirit stofi që lidhë ose bashkon shpinën librit me kapakët
Ornament	zbukurim piktorial, grafik ose skalitës
Papirus	fletë e hollë e prerë nga kërcëjtë e kësaj bime dhe e përpunuar, që përdoret nga egjiptasit dhe nga popuj tjerë të lashtë si letër për të shkruar
Pastë	ngjitës, përzierje e ujit me miell orizi ose nisheste
Pergamenë	lëkurë kafshës (dhie, keci, qengji etj.) që përpunohej posaçërisht dhe përdoret për të shkruar në të (para se të shpikëj letra për të shkruar); ose dokument a libër i shkruar në këtë lëkurë
Restaurim	ndreqje, përmirësim-sjellje përsëri në gjendje të mirë një vepër arti të dëmtuar
Reversibil	i rikthyeshëm, që mund të kthehet përsëri në gjendjen e mëparshme

Riparim	ndreqje, meremetim
Shiritat ngjitës	materiale letre, pëlhure apo lloj tjetër në formë fletëze me një shtresë ngjitëse. Ngjitësi aktivizohet zakonisht me anë të shtypjes apo me anë të aplikimit të nxehjes
Shpatull	vegël dore që përdoret për operacione të ndryshme gjatë procesit të restaurimit

BIBLIOTEKA KONJËTINE DHE UNIVERSITETIT E KOSOVËS		THE NATIONAL AND UNIVERSITY LIBRARY OF KOSOVO
Nr. rregull _____ Data _____		
I. Përshkrimi i gjendjes së dokumentit		
1. Lloji i materialit bibliotekar _____		
2. Formati _____		3. Nr i fq _____
3. Shënime bibliografike:		
a. No i inventarit _____		
b. Titulli _____		
c. Viti e vendi i botimit _____		
d. Shprehkimeja _____		
4. Lidhja, materialet, teknikat e përdorura _____		

5. Kapakët (kopertinat) _____		
6. Këmbizat _____		
7. Fastkapi, përberja – veçoritë _____		
8. Materiali ku shkruhet, teknikat e shkruarit, ilustrimet _____		

9. Llojet e dëmtimeve (biologjike, mekanike, kimike) _____		

II. Procedura e riparimit		

Data _____		Restaurator - Konservator _____

Tabela për përshkrimin e procedurave të punës gjatë restaurimit dhe konservimit të librit

Burime të rekomanduara nga interneti për restaurim dhe konservim

Standardizing Agencies

Association for Information and Image Management International (AIIM)
<http://www.aiim.org/>

ISO (International Standards Organization)
<http://www.iso.ch/welcome.html>

National Information Standards Organization (NISO)
<http://www.niso.org>

National Institute of Standards and Technology
<http://www.nist.gov>

Occupational Safety and Health Administration (OSHA)
<http://www.osha.gov>

National Institute for Occupational Safety and Health (NIOSH)
<http://www.cdc.gov/niosh.homepage.html>

General Resources
American Institute for Conservation of Historic and Artistic Works (AIC)
<http://www.aic.edu>

American Library Association (ALA)

<http://www.ala.org>

Amigos

<http://www.amigos.org>

Council on Library and Information Resources (CLIR)

<http://www.clir.org>

Conservation OnLine (CoOL)

<http://palimpsest.stanford.edu>

Abbey Publications

<http://palimpsest.stanford.edu/byorg/abbey/>

International Council of Museums (ICOM)

<http://palimpsest.stanford.edu/icom/>

Institute of Paper Conservation (IPC)

<http://palimpsest.stanford.edu/ipc>

European Commission on Preservation and Access

<http://www.knaw.nl/ecpa>

Getty Conservation Institute

<http://www.getty.edu/gci>

**International Federation of Library Associations (IFLA)
Section on Preservation and Conservation**

<http://www.ifla.org>

Institute of Museum and Library Services

<http://www.ims.fed.us>

Library of Congress Preservation Directorate

<http://lcweb.loc.gov/preserv>

National Archives and Records Administration (NARA)

<http://www.nara.gov>

National Center for Preservation Technology and Training (NCPTT)

<http://www.ncptt.nps.gov>

Photographic/Audio/Video

Albumen

<http://albumen.stanford.edu>

American Film Institute

<http://www.afionline.org/preservation/>

Association of Moving Image Archivists (AMIA)

<http://www.amianet.org/>

George Eastman House

<http://www.geh.org>

VidiPax—Magnetic Media Restoration Company

<http://www.vidipax.com>

Digital

Berkeley Digital Library

<http://sunsite.berkeley.edu/Preservation>

Digital Library Federation

<http://www.clir.org/diglib/dlfhomepage.htm>

Preserving Access to Digital Information

<http://www.nla.gov.au/padi/>

Environmental and Lab Safety

Center for Disease Control (CDC)

<http://www.cdc.gov>

Fungi and Bacteria in Indoor Air Environments (Eastern NY Occupational and Environmental Health Center)

<http://www.bioaerosol.com/>

Material Safety Data Sheets

<http://www-ehs.ucsd.edu/msds.htm>

Mycological Aspects of Indoor Environmental Quality

<http://www.dehs.umn.edu/iaq/fungus/>

National Fire Protection Association

<http://www.nfpa.org/>

Literatura

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës “**IFLA - Parimet mbi përkujdesjen dhe përdorimin e materialit bibliotekar**” Prishtinë,

Kalenja, Alida: “**Ruajtja dhe Mirëmbajtja e dokumentave bibliotekare**” (brochure) Departamenti i Mirëmbajtjes së Librit, Tiranë

Mekolli, Bedrije: “**Si i zgjatet jeta librit**”, Kosova Sot, Prishtinë, 4 shkurt 2004

Milevski, J. Robert: “**Preservation and Conservation Workshop Manual**”, The Milton S. Eisenhower, Library of The Johns Hopkins University, 1988

Plenderleith, J. H.; Werner, A.E. A. “**Conservation of Antiquities and Works of Art**”, 1979

Radosavljeviq, Vera: “**Zaštita i ?uvanje biblioteke i arhivske grace**” Beograd, 1986.

The Milton S. Eisenhower “**Hands-On Preservation Workshop**” Library of The Johns Hopkins University, 1988

Khaja, Farfuri: “**Koleksionet e Bibliotekës**”, Biblioteka Kombëtare, Tiranë, 2002

Përgatiti: Bedrije Mekolli

**PROBLEMET E PËRGJITHSHME TË
RUAJTJES DHE KONSERVIMIT
TË MATERIALIT BIBLIOTEKAR**

Qendra e Restaurimit dhe e Konservimit

Botues:

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, Prishtinë,
2005

Shtypi:

“Prograf”
Prishtinë

Katalogimi në publikim - (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

025.7 /.9

PROBLEMET e përgjithshme të ruajtjes dhe konservimit të materialit bibliotekar / Përgatiti: Bedrije Mekolli ; [Fotografite Bashkim Binaku]. - Prishtinë : Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, 2005 (Prishtinë : „Prograf”). - 44 fq.: ilustr. 19 cm.

1.MEKOLLI, Bedrije

ISBN 9951-13-015-1